

Intervistë e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorit Pavel Vacek

Gazetar: Skënder Minxhozi

1. I nderuar Zoti Ambasador, procesi zgjedhor në Shqipëri sapo ka mbaruar. Si e gjykoni ju në tërësi mënyrën se si u zhvilluan zgjedhjet?

Vlerësimi përfundimtar rreth zgjedhjeve do të bëhet nga Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it. Unë mund të jap vetëm një mendim personal. Mendoj se zgjedhjet janë zhvilluar më mirë se në të shkuarën, por jo në nivelin që duhet. Niveli i lartë i pjesëmarrjes në zgjedhje është tregues i interesit të votuesve shqiptarë rreth të ardhmes së vendit të tyre. Gjatë këtyre zgjedhjeve, pati shumë vëzhgues shqiptarë, gjë që përbën një arritje tjetër të zgjedhjeve të fundit. Shumë nga komisionet zgjedhore bënë më të mirën e mundshme dhe unë kam parë disa nga këto komisione të punonin në harmoni dhe qetësi në vende ku jeta është tepër e vështirë. Komisione të tjera nuk arritën të punonin në të njëjtën frymë, për shkak se ndjenjat e polarizuara politike ishin më të forta sesa paanësia në detyrë, dhe kjo ka qenë një ndër problemet më të mëdha gjatë këtyre zgjedhjeve. Insitucionet kryesore zgjedhore kanë punuar shumë për të përballuar numrin e madh të ankesave. Policia, gjithashtu, ka kryer detyrat e saj gjatë ditëve të zgjedhjeve.

2. Është debatuar gjerësisht lidhur me afatet e zgjatura të shqyrtimit ligjor të ankimimeve nga ana e forcave politike. A përbën edhe për organizatën tuaj ky faktor një element shqetësimi?

Kjo është edhe organizata juaj...Shqipëria është pjesë e OSBE-së. Një shqetësim shqiptar përbën një shqetësim edhe për ne. Padyshim, zvarritja artificiale e procesit zgjedhor për shkak të ankimimeve dhe apelimeve përbën shqetësim edhe për ndërkombëtarët.

3. Kur mendoni se do të bëhet publik raporti i grupit të vëzhguesve të OSBE/ODHIR-it ?

Ju edhe mund të jeni njoftuar nga Jørgen Grunnet që raporti përfundimtar i zgjedhjeve do të bëhet publik një muaj pas shpalljes së rezultateve përfundimtare.

4. Paraprakisht, është deklaruar se këto zgjedhje përbëjnë një moment të rëndësishëm për të gjykuar lidhur me ecurinë dhe ritmet e afrimit të vendit tonë në BE. A mendoni se Shqipëria e kaloi këtë test?

Kjo pyetje është më mirë t'i drejtohet Komisionit Evropian dhe Prezencës së BE-së. Megjithatë, unë mendoj se Shqipëria nuk i përmirëson legjislacionin dhe insitucionet e saj demokratike vetëm që një ditë të hyjë në BE. Ky përmirësim është në interesin e vendit dhe përfaqëson një objektiv përfundimtar në vetvete.

5. Ende pa mbaruar procesi zgjedhor i 3 korrikut, janë dëgjuar pakënaqësitë e para nga ana e faktorëve politikë lidhur me sistemin zgjedhor. A besoni se do të ketë retushime të Kodit Zgjedhor në muajt e ardhshëm? A mendoni ju se një sistem votimesh me bazë proporcionale do të ishte një formulë më e mirë se kjo e tanishmja?

Sistemi zgjedhor i tanishëm në Shqipëri është i ndërlikuar dhe krijon hapësira për abuzime, të cilat ne i kemi vënë re. Megjithatë, ka ekspertë të cilët argumentojnë që një sistem mazhoritar i përzier me sistemin proporcional është shumë modern dhe përparimtar. Në qoftë se ekziston vullneti politik për të bërë ndryshime të mëtejshme përmirësuese të ligjit aktual zgjedhor, ne do të jepnim ndihmën tonë në këtë proces. Ne do të ndihmojmë njësoj edhe sikur forcat politike të zgjedhin një nga variantet e sistemit proporcional. Nuk ka ndonjë standard ndërkombëtar se cili nga sistemet është më i mirë. Por ekzistojnë disa sugjerime dhe përvoja nga OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës, të cilat mund të ndihmojnë në detajet e sistemit dhe bazën e nevojshme ligjore. Prezenca këtu nuk do të jetë arbitër i korrektesës së zgjedhjeve themelore që do të bëhen nga përfaqësuesit e politikës shqiptare. Ajo që duhet të jetë e qartë qysh në fillim është se nuk ka një sistem zgjedhjesh të pakritikueshëm, dhe se të gjitha sistemet e zgjedhjeve mund të shfrytëzohen, pengohen ... ose sabotohen, nëse ekziston vullneti për ta bërë këtë.

6. A mendoni se rotacioni politik që po ndodh do të krijojë probleme në marrëdhëniet e Shqipërisë me bashkësinë ndërkombëtare?

Nuk më takon mua të them... Por pse duhet të krijojë probleme? Ndryshime qeverish ndodhin kudo në botën demokratike herë pas here dhe jeta vazhdon normalisht. Zgjedhjet e drejta në demokraci janë të kufizura, programet e partive politike konvergojnë në çështje strategjike politike... Pa dyshim, ju e dini përgjigjen e duhur... gjithçka varet nga politikat që ndiqen sesa nga ato që deklarohen.

7. Si e shihni rolin e OSBE-së në zhvillimet e ardhshme në Shqipëri? Sa e besoni ju tezën sipas të cilës procesi i integritit evropian ku ka hyrë Shqipëria dhe mekanizmat e monitorimit të BE-së në përgjithësi krijojnë një farë mbivendosjeje me punën dhe veprimtaritë e OSBE-së në Shqipëri?

Ajo çka ne bëjmë konsultohet mirë me Komisionin dhe Presidencën e BE-së dhe është në përputhje me objektivat e BE-së dhe Shqipërisë në kuadrin e procesit të integritit. Puna jonë kontribuon, në disa raste drejtpërsëdrejti, në aspiratat e Shqipërisë për në BE. Dublinet janë një luks që ne nuk kemi mundësi ta përballojmë. A mund të më thotë dikush se ku janë këto mbivendosje?

8. Vitet e fundit, ka pasur një reduktim gradual të veprimtarive të OSBE-së në Shqipëri, veçanërisht, në lidhje me mbylljen e disa zyrave rajonale. Si e shihni këtë proces?

Ka pasur një prirje të përgjithshme drejt reduktimit, motivuar si nga brenda, ashtu edhe jashtë Shqipërisë. Ndërsa pakësimet e përgjithshme të buxhetit të përbashkët të OSBE-së

janë pasojë e vullnetit kolektiv të 55 vendeve anëtare të OSBE-së, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, disa nga thirrjet për pakësim që vijnë nga brenda Shqipërisë motivohen nga bindja e gabuar se një shkurtim i buxhetit apo strukturës së Prezencës tregojnë përparim. Kjo nuk është kështu... për sa kohë ekzistojnë probleme dhe mangësi... dhe kjo është ajo që unë dua të vë në dukje. Nga ana tjetër, unë jam, gjithashtu, në dijeni se qeveria që pritet të vijë në pushtet kërkon më shumë ndihmë nga ana jonë dhe jo më pak dhe kjo kërkesë duhet repektuar nga ne. Është e ditur tashmë që ne kemi propozuar një rritje zero për buxhetin e Prezencës për vitin 2006, ne do t'i zëvendësojmë disa punonjës ndërkombëtarë me shqiptarë, ashtu sikurse mund të reduktojmë numrin e përgjithshëm të punonjësve. Me fjalë të tjera, ne po përgatitemi të bëjmë të njëjtën sasi pune, ose edhe më tepër, me të njëjtat, ose me më pak, burime në dispozicion. Natyrisht, do të vijë një ditë kur Prezenca në Shqipëri do të mbyllet dhe kjo do të paraprihet nga një periudhë më e madhe reduktimi. Por, përpara se të flasim për këtë, do të ishte më e arsyeshme për ne që të përpiqeshim të maksimizojmë efektshmërinë e burimeve të kufizuara të Prezencës së OSBE-së, sesa të përballemi me fushatat kundër zyrave tona rajonale që kanë mbetur. Unë e di që këto zyra rajonale pëlqehen nga autoritetet vendore dhe njerëzit dhe unë mendoj që ato janë të nevojshme për punën tonë të mëtejshme.